



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
U PËR NGRËNJE PËR VËRTETË TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI

Nr./Br. 421,428/22
Date/Datum. 24.11.2022

PRISHTINË - PRISTINA
Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



PSH.nr.421-428/22

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje të: z. Agon Ramadani– Kryetar, znj. Kimete Gashi Referuese, z. Vedat Poterqoi – Anëtar, duke vendosur sipas ankesave të parashtruara nga operatorët ekonomik, OE "Krasniqi B.I.-D.P.Z Suzuki" - Fushë Kosovë si dhe OE: "NTSH BESI"-Prishtinë, kundër njoftimit mbi vendimin e autoritetit kontraktues, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Servisimi dhe mirëmbajtja e automjeteve te QKMF-së dhe /QMU-se" me nr.prok 616-22-3585-2-1-1, të iniciuar nga AK- "KK Prishtinë", më datën: 22.11.2022, morri këtë:

V E N D I M

I. Anulohet, në tërësi, aktiviteti i prokurimit me titull: "Servisimi dhe mirëmbajtja e automjeteve te QKMF-së dhe /QMU-se" me nr.prok 616-22-3585-2-1-1, të iniciuar nga AK- "KK Prishtinë"

II. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

III. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues

IV. Me qenë se aktiviteti i prokurimit, i cekur në pikën I të këtij dispozitivi është anuluar në tërësi, i bëhet kthimi i mjeteve të dy OE ankues.

A R S Y E T I M

Me datën 01.09.2022 dhe 31.08.2022, OE "Krasniqi B.I.-D.P.Z Suzuki" - Fushë Kosovë si dhe OE: "NTSH BESI"-Prishtinë ka parashtruar ankesë me nr: 421-428/22, kundër njoftimit për dhënie te Kontratës për aktivitetin e prokurimit "Servisimi dhe mirëmbajtja e automjeteve te QKMF-së dhe QMU-se" me nr.prok 616-22-3585-2-1-1, të iniciuar nga AK- "KK Prishtinë"

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: furnizim, vlera e parashikuar e kontratës: 150,000.00€

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 06.09.2022, ka autorizuar ekspertin shqyrtues të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti shqyrtues i prokurimit në raportin e dt: 09.09.2022, lidhur me pretendimet ankimore të OE-ankues ka dhënë rekomandimin si në vijim:

MENDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesat e OE ankues janë të bazuar, ndërsa të anulohet njoftimi për dhënie të kontratë dhe lënda të kthehet në Ri-vlersim.

Organi shqyrtues i prokurimit i ka njoftuar palët me datë: 09.09.2022, me raportin e ekspertizës.

Autoriteti Kontraktues, me datë: 13.09.2022, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se nuk pajtohet me mendimin e ekspertit.

Operatori Ekonomik OE "Krasniqi B.I.-D.P.Z Suzuki" - Fushë Kosovë, me datë: 12.09.2022, ka njoftuar OSHP-në, se pajtohet mendimin e ekspertit 421/22.

Operatori Ekonomik: "NTSH BESI", me datë: 12.09.2022, ka njoftuar OSHP-në, se pajtohet me mendimin e ekspertit 421,428-22.

Seanca kryesore shqyrtuese është mbajtur me datën 19.10.2022, pa praninë e palëve, konform nenit 24.1 të Rregullores së OSHP-së, për shkak se nuk është konsideruar e arsyeshme qe te ftohen palët përfaktin se ka pasur prova dhe argumente te mjaftueshme në shkresat e lëndës, si dhe duke qenë se të gjitha të dhënat në këtë rast kanë qenë të qarta dhe pa nevojë për sqarime shtesë, paneli ka vazhduar me mbajtjen e seancës kryesore si dhe këshillim-votimin.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues, deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor, sqaron;

Lidhur me pretendimet ankimore të dy OE ankues të paraqitura ne ankesat e tyre kundrejt OE të rekomanduar për kontratë "OE Europa – Bastri Ademi B.I" si dhe GOE të pasuksesshëm "Sfishta Auto Home Sh.P.K; N.T.Sh Sfishta", Paneli Shqyrtues konstaton se nuk ka qenë e mundur që ankesat e tyre të trajtohen në mënyrë meritore duke qenë se kemi pasur të bëjmë me dosje jo të përpiluar qartë, në të cilën ka pasur lëshime të konsiderueshme në aspektin e përpilimit nga ana e AK, andaj Paneli Shqyrtues konstatoi se zgjidhja më e mirë në këtë rast do të ishte anulimi i tërësishëm i këtij aktiviteti, si dhe në rast se AK ka interes që ta ri-tenderoj, obligohet që lëshimet të cilat do ti cekim më poshtë ti përmirësoj, kështu duke mundësuar mundësi të barabartë për të gjithë ofertuesit e interesuar e gjithashtu duke devijuar mundësinë e diskriminimit të tyre në të ardhmen duke pasur parasysh qëllimin e kontratës.

Në paramasën e përpiluar nga AK, të cilën AK veçse e kishte përmirësuar një herë para ofertimit, PSH ka vërejtur se ka pasur shumë pozicione jo të qarta dhe në kundërshtim me qëllimin e kontratës, andaj PSH ka konstatuar se, si e tillë eventualisht do të kishte gjasa të mëdha që të

mundësonte manipulime të çmimit, gabime në vendosjen e çmimeve nga OE ofertues, vendosjen e çmimeve që nuk koïncidojnë me çmime të tregut, e për më tepër vështirësi të konsiderueshme edhe në zbatim të kontratës, andaj duke pasur parasysh parimet themelore të LPP-së, siç janë kursimi i buxhetit të shtetit, trajtimi i barabartë, efikasiteti e ekonomociteti, PSH erdhi deri tek vendim-marrja sikurse në dispozitiv.

Vlen të ceket në këtë paramasë, fillimisht kemi pasur pozicione lidhur me artikuj që realisht nuk përfshihen në tender (psh, pjesë të automjeteve dedikuar atyre të tipit benzinë, ndërsa automjeti për të cilin ka qenë dashtë të ofertoheq ka qenë i tipit me naftë, apo shumë artikuj tjerë që realisht nuk janë pjesë përbërëse e një automjeti fare, etj), lidhur me këtë, AK në versionin e parë të paramasës disa nga hapësirat e paramasës si të tillë i ka pamundësuar pjesëmarrësve që ata të vendosin çmime në të, duke vendosur në këto fusha simbolin N/A, që sipas panelit ka qenë veprim i drejtë dhe konform praktikave dhe legjisacionit në fuqi, por pas kërkesave për sqarime nga OE, AK ka përmirësuar paramasën, ndërsa fushat e myllura në versionin fillestar të paramasës tanimë janë të hapura në versionin e përmirësuar ndërsa edhe më tej kemi artikuj që nuk përfshihen në tender, lidhur me këtë veprim të ndërrmarrë nga AK, Paneli konstaton se përveç që ajo nuk është përmirësuar, në të kundërtën vetëm është vështirësuar gjendja në masë të madhe, kështu duke mundësuar ofertuesve të vendosin çmime që nuk janë të përfshira në tender e sidomos përfaktin se në përgjigjen e dhënë nga AK, me të cilën se lidhur me këtë rast theksohet vijim: “*AK eshte munduar qe sa me shume te perfshije artikuj te automjeteve ne menyre qe gjate realizimit te kontrates mos per te paraqiten realizim te kontrates. veshteresi OE eshte i obliguar qe ta plotesoj tere paramasen e dhene nga AK.*” Rrjedhimisht, PSH konstaton se si rezultat, OE ofertues kanë vendosur çmime prej 0.00, 0.10, e çmime të tillë të ngjashme në shumë pozicione, që përveç nuk janë çmime tregu, në raste të caktuara nuk lejohen fare.

Aspekti tjetër që Paneli e konsideron se ka luajtur rrol kyç në pamundësimin e vlerësimit të kësaj lënde, ka qenë fakti që në këtë paramasë kemi pasur pozicione të përsëritura, njëra ndër kryesoret ka qenë pozicioni me të cilin dy OE kanë paraqitur pretendime në ankesat e tyre, poz.16 “Bateri (akumulator) me amperazh sipas amperazhes qe kerkohet per vture” ndërsa poz.117. ka qenë “Ndërrimi i akumulatorit,çmimi për 1 Amper”, dy pozicionet me emërtime identike, siç janë 59 dhe 67 pozicioni “Gome vaji (per nyje)” e shumë pozicione të tjera me emërtime të tjera apo të

ngjashme e funksione të njëjta, të gjitha këto pretendime të ngritura në ankesat e OE ku përveç të tjerash të gjitha hapësirat për vendosjen e çmimit në këto pozicione kanë qenë të hapura, kështu që si rrjedhojë Paneli Shqyrtues konstaton se në këtë rast, përveç se është krijuar paqartesi në cilën fushë apo pozicion të jepet çmimi, OE kanë ofertuar me çmime prej 1, 10 e 5 centësh, një tjetër OE ka vodosur tekstin “përsëritje me poz.xx” në 12 pozicione, që të gjitha këto raste PSH konsideron se kanë mundësuar ofertim me çmime jo të rregullta, abnormalisht të ulëta e gjithashtu manipulative, e që si pasojë bien ndesh me parimet e jo-diskriminimit si dhe me legjislacionin përkatës, kështu që, Paneli Shqyrtues, nëse evidenton se zyrtari përgjegjës i prokurimit, në të ardhmen, bënë gabime tjera të mëdha, sikur ky, dhe patjetër aktiviteti i prokurimit duhet të anulohet si rrjedhojë e gabimeve të tij, atëherë me një shkresë do ti drejtohet KRPP-së, dhe do të kërkojë që të veprojë konform nenit 25 të LPP-së.

Andaj, PSH konstaton se hartimi i kësaj Dosje të tenderit ka qenë në kundërshtim me nenin 27 të LPP-së, paragrafi 1, e posaçërisht duke u mbështetur në nenin 47.14 i RRUOPP-së, i cili citon: *“Autoriteti kontraktues duhet të marrë një qasje të ngjashme jo-kufizuese kur zbulon se dosja e tenderit që ka lëshuar mund të ketë mangësi të caktuara ose mund të jetë më pak e qartë në disa pika. Kjo megjithatë nuk duhet që në asnjë rrethanë të çojë në ndonjë ndryshim de facto në kërkesat teknike dhe të tjera të dosjes së tenderit. Nëse autoriteti kontraktues vjen në përfundimin se tenderi i planifikuar është në fakt i papërshtatshëm atëherë ajo nuk do të jetë e mundur për të "riparuar" në dosjen e tenderit me anë të informacionit shtesë ose sqarime. Qasja e vetme në dispozicion në situata të tilla është që të anulojë tenderin dhe të fillojë një procedurë tjetër në bazë të një dosjeje të tenderit të ndryshuar.”*

Bazuar në kompetencat e OSHP të parapara me nenin 105, lidhur me nenin 106 të LPP, Paneli Shqyrtues vuri në zbatim mes tjerash dhe nenin 103 të Ligjit të cituar sipas të cililit të gjitha palët e interesuara do të kenë qasje të barabartë në procedurat për shqyrtimin e prokurimit dhe në mjetet juridike dhe se, asnjë vendim i OSHP, nuk do të merret ose bëhet në mënyrën me të cilën diskriminohet në të mirë ose në dëm të një pjesëmarrësi në procedurë ose të një personi ose ndërmarrje tjetër.

Bazuar në të lartcekurat, Paneli shqyrtues vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi, në pajtim me nenin 117 të LPP.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

z. Agon Ramadani

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK – "Prishtinë",

1x1 OE - "Krasniqi B.I.-D.P.Z Suzuki" - Fushë Kosovë si dhe OE: "NTSH BESI"-Prishtinë,

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.